



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

NR. _____ DATË _____ 2019

PËR

“PËRCAKTIMIN E MASËS, KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT, PËR VLERËSIMIN E PËRFITIMIT E AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL SI DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE DETYRAT E TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 30, shkronja c, të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

I. OBJEKTI DHE SUBJEKTET PËRFITUESE

1. Modeli bio-psiko-social i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, do të zbatohet në qarkun Tiranë sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim dhe nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar.

2. Në vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar do të përfshihen:

a) individët që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë;

b) individët që kërkojnë të rivlerësohen, të cilët kanë përfituar pagesë të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET E PËRFITIMIT DHE DOKUMENTACIONI I PRANIMIT

1. Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) personi të ketë një gjendje mjekësore të vërtetuar të një dëmtimi fizik, mendor, intelektual apo shqisor të lehtë mesatar, të rëndë ose të thellë;

b) të vërtetohen kufizime të lehta, mesatare, të rënda ose të thella, të shkaktuara nga dëmtimi;

c) të vërtetohen kufizime mesatare, të rënda, të thella për të kryer veprimtari domethënëse të jetesës së përditshme, të përshtatshme për moshën e personit dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike;

ç) personi të përjetojë kufizime të konsiderueshme mjedisore dhe qendrimore, të cilat ndikojnë në aftësinë për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri;

d) personi të jetë mbi moshën 2 vjeç;

dh) personi është i paaftë për punë, dhe nuk plotëson kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

e) personit nuk i ka lindur e drejta për përfitim të pensionit të pleqërisë/social sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

2. Dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar përfshin:

a) formularin e aplikimit sipas formatit nr. 1;

b) formularin e plotësuar nga mjeku i familjes sipas formatit nr. 2 ose 3 bashkëlidhur këtij vendimi;

c) formularin e plotësuar nga mjeku specialist i qendrave shëndetësore të specialiteteve apo spitaleve kur nuk mbulohet nga qendrat shëndetësore sipas formatit nr. 4 ose 5 bashkëlidhur këtij vendimi. Për sëmundjet e shëndetit mendor ky formular plotësohet nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (QKSHM). Për fëmijët formulari mund të plotësohet edhe nga Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (QKMZHRF);

ç) dokument identifikimi me fotografi.

3. Dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu, dorëzohen/postohen pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

III. VLERËSIMI BIO-PSIKO-SOCIAL

1. Procesi i mbështetur në modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar përfshin vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku i familjes dhe nga mjeku specialist/QKSHM-ja, një intervistë me aplikuesin në Zyrën Rajonale të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë të kufizuar, me mjekë dhe punonjës socialë, verifikimin e informacionit të marrë dhe kontrollin vjetor mjekësor.

2. Vlerësimi bio-psiko-social i aftësisë së kufizuar dhe nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funksionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe për shëndetësinë.

3. Administrimi i procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.

4. Pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror krijohen komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të cilat funksionojnë në nivel rajonal, të cilat përbëhen nga punonjës me kohë të plotë dhe kanë në përbërje së paku një mjek dhe një punonjës social për çdo komision, të trajnuar për modelin bio-psiko-social të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar. Çdo komision asistohet nga një punonjës i cili administron dhe regjistron të dhënat e aplikuesit. Komisionet kryesohen nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Komisionet kanë këto detyra:

- a) hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave të aplikuesit;
- b) vlerësimin dhe shqyrtimin e dosjeve të paraqitura për vlerësim/rivlerësim;
- c) verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit elektronik me rrjetin e institucioneve të tjera të kujdesit shëndetësor, të arsimit, punësimit e formimit profesional, sigurimeve shoqërore, tatimeve, strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor, si dhe institucioneve të tjera, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe, kur nuk është e mundur, manualisht/zyrtarisht;
- ç) caktimin e datës së intervistës dhe njoftimin zyrtarisht të kërkuesit nëpërmjet administratorit shoqëror ose kthimin zyrtarisht të dosjes për plotësim, kur ka mungesë dokumentacioni, njësisë administrative;
- d) organizimin dhe kryerjen e intervistës sipas formatit nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit apo në një afat më të shkurtër për rastet për të cilat kërkohet procedurë e përsheptuar;
- dh) vlerësimin për përcaktimin e nevojës për ndihmës personal, sipas formatit nr. 7, bashkëlidhur këtij vendimi
- e) përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të aftësisë së kufizuar sipas formatit nr. 8, bashkëlidhur këtij vendimi
- ë) përgatitjen e rekomandimeve për shërbime të tjera dhe marrjen e vendimit për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar;
- f) lëshimin e dokumentit që vërteton aftësinë e kufizuar, sipas formatit nr. 9, bashkëlidhur këtij vendimi;
- g) shqyrtimin e të dhënave të kontroleve periodike të nevojshme të kryera sipas formatit nr. 10, bashkëlidhur këtij vendimi.
- gj) mbajtjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave e të dokumentacionit të kërkuesve e të përfituesve të aftësisë së kufizuar, elektronikisht dhe fizikisht.

5. Personat, të cilët kanë një shfaqje të menjëhershme të një sëmundjeje të rëndë ose një humbje të plotë e të menjëhershme të aftësive funksionale për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme, mund të kualifikohen për procesin e përsheptuar të vlerësimit, i cili do të kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit.

6. Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar, njofton zyrtarisht aplikuesin mbi vendimmarrjen dhe e pajis me dokumentin përkatës që përcakton aftësinë e kufizuar. Vendimi për përfitimet e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal i përcillet bashkisë për:

- a) zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit;
- b) kryerjen e veprimeve financiare për kryerjen e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar.

7. Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor ka këto përgjegjësi lidhur me menaxhimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara:

- a) hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;
- b) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, çdo tre muaj;
- c) informimin e zyrës së vlerësimit mbi ndryshimin e gjendjes së personit me aftësi të kufizuara;
- ç) informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë /njësisë administrative në territorin e së cilës është banor individi;
- d) informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar;
- dh) informimin e familjarëve për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore;
- e) monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale;
- ë) evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të abuzimit e të neglizhencës;
- f) evidentimin dhe verifikimin e rasteve të personave që përfitojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, të informojnë strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror për të kryer verifikimet me institucione të tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre, kur kanë dijeni;
- g) të ndërpresin pagesën e aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, me përjashtim të personave e të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë;
- gj) të ndërpresin pagesën e aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, si dhe të rasteve të përfituesve të cilët ndodhen jashtë shtetit shqiptar për qëllime kurimi apo rehabilitimi;
- h) të informojnë dhe të udhëzojnë komunitetet lidhur me skemën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;
- i) të bashkëpunojnë me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në nenin 36, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë;
- j) të adresojnë rastet e personave me aftësi të kufizuar drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore e të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore, në përputhje edhe me rekomandimet e komisionit.

8. Monitorimi i punës së zyrave rajonale për vlerësimin e aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror në bazë të metodologjisë së kontrollit.

9. Trajnimet e stafit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

IV. PËRFITIMET NË PAGESA DHE SHËRBIME

1. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore e cila jepet në muajin pasardhës nga data e vendimit për përfitime, me qëllim përmbushjen e nevojave elementare, të lidhura me aftësinë e kufizuar, e cila përfitohet nga personat të cilët janë deklaruar si të tillë me vendim të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

2. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet nga Shërbimi Social Shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi.

a) personat mbi 18 vjeç me kufizime të lehta referohen për të përfituar shërbime/punësim ose, në mungesë të tyre, përfitojnë 60% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

b) personat mbi 18 vjeç me kufizime mesatare përfitojnë 80% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

c) personat mbi 18 vjeç me kufizime të rënda përfitojnë 100% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

ç) personat mbi 18 vjeç me kufizime të thella përfitojnë 120% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

d) fëmijët me kufizime të lehta referohen për të përfituar shërbime ose në mungesë të tyre përfitojnë 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime të lehta, të përcaktuar në shkronjën "a", të kësaj pike;

dh) fëmijët me kufizime mesatare përfitojnë 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime mesatare, të përcaktuar në shkronjën "b", të kësaj pike;

e) fëmijët me kufizime të rënda përfitojnë 75% të shumës që përfitojnë personat madhorë me kufizime të rënda, të përcaktuar në shkronjën "c", të kësaj pike;

ë) fëmijët me kufizime të thella përfitojnë 75% të shumës që përfitojnë personat madhorë me kufizime të thella, të përcaktuar në shkronjën "ç", të kësaj pike.

3. Përfituesit e aftësisë së kufizuar të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Niveli i pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit.

5. Pagesat për personat me aftësi të kufizuara kryhen përmes shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi.

6. Pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar ndërpriten, kur:

- a) përfituesi nuk ka dorëzuar formularin vjetor mjekësor të plotësuar nga mjeku specialist deri në 30 ditë kalendarike pas datës së përcaktuar për dorëzimin e tij;
- b) përfituesi nuk ka ndjekur procedurat e rivlerësimit deri në 30 ditë kalendarike pas datës së përcaktuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
- c) personi refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara;
- ç) personi refuzon marrjen e shërbimit të rekomanduar;
- d) verifikohet mashtrimi apo shpërdorimi dhe nisin procedurat për kthimin e të gjitha shumave të përfituara padrejtësisht;
- dh) zyrat rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit raportojnë për mungesën e bashkëpunimit nga ana e përfituesve, të cilët janë rekomanduar për t'u punësuar dhe/ose për të mbajtur një vend pune apo kanë refuzuar deri në dy herë ofertat e përshtatshme të punës nga zyrat e punës;
- e) përfituesi ka qëndruar jashtë vendit më shumë se 3 muaj, me përjashtim të personave e të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë;
- ë) personi nuk paraqitet në komisionin e nivelit më të lartë dy herë radhazi.

7. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit.

8. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për titujt/gradat shkencore dhe përfitohet në mënyrë të përherëshme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente.

9. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, duhet të paraqesin për çdo fillim të vitit akademik edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i shkollës, ku të shënohen:

- i) Emri i personit që ndjek shkollën;
- ii) Lloji i arsimit që ndjek;
- iii) Vitin shkollor / kohëzgjatjen.

b) Vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i shkollës për frekuentimin e shkollës nga personi përfitues (çdo tre muaj).

c) Kopjen e noterizuar të dëftesës të çdo viti dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme apo të lartë, si dhe kopje të dëshmisë të kursit të formimit profesional.

ç) Vërtetimin se ka shlyer detyrimet për çdo sezon, për arsimin e lartë.

10. Personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë titull/gradë shkencore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 8 të këtij kreu, duhet të paraqesin edhe kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton mbrojtjen e gradës shkencore.

11. Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror ose rajonal ka të drejtë të verifikojë me strukturat përgjegjëse për çështjet e arsimit vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga ana e institucioneve arsimore.
12. Janë në kushtet e përfitimit të ndihmësit personal personat që përmbushin kriteret e mëposhtme:
- a) kanë kufizime të rënda ose të thella të aftësive funksionale për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme, të përshtatshme për moshën dhe për të marrë pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe politike të shoqërisë;
 - b) kanë nevojë për ndihmë për të kryer veprime bazike të lidhura me jetesën e përditshme dhe për pjesëmarrje në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, sipas përcaktimeve të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;
13. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmësit personal, gjithëpërfshirëse apo të herëpashershme, përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
14. Ndihmësit personalë përzgjidhen nga përfituesit, kujdestari ligjor/prindi ose përmes procesit të vendimmarrjes së mbështetur dhe mund të ofrohen nga anëtarë të familjes, të afërm të përfituesit ose familjes, përfaqësues ligjorë ose agjenci të specializuara, të regjistruara dhe të licencuara.
15. Shërbimi i ndihmësit personal ofrohet nga individë të cilët kanë vendbanimin në Shqipëri, brenda së njëjtës bashki me personin me aftësi të kufizuara, kanë aftësi mendore dhe fizike për të ofruar këto shërbime dhe nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë.
16. Shërbimet e ndihmësit personal rregullohen përmes një kontrate ose deklarate ndërmjet marrësit të shërbimeve ose përfaqësuesit ligjor dhe ofruesit të shërbimit.
17. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal lidhen me pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar dhe indeksohen nga Shërbimi Social Shtetëror në bazë të indeksimit të pensionit social.
18. Shuma e pagesës për shërbime gjithëpërfshirëse është 120% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar.
19. Shuma e pagesës për shërbime të herëpashershme është 80% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar.
20. Ndihmësit personalë, që ofrojnë këtë shërbim për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.
21. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal jepen në muajin pasardhës pas vendimit të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit. Pagesa kryhet përmes shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi.
22. Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT

1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim brenda 20 (njëzetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror;

2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimimit administrativ.

3. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit do t'i lindë e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni ose sipas përcaktimeve në vendimin e gjykatës.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi:

a) të verbërit përfitues ose aplikues që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbërit;

b) paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitues ose aplikues që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.

2. Shërbimi Social Shtetëror miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe rajonal dhe protokollin e punës së tyre.

3. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore dhe sociale dhe njësitë e qeverisjes vendore në të cilat zbatohet kjo skemë vlerësimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TE MINISTRAVE

PËR

“PËRCAKTIMIN E MASËS, KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT, PËR VLERËSIMIN E PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL SI DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE DETYRAT E TYRE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim të bëjë të mundur vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, të bazuar në modelin konceptual të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit dhe Shëndetit (KNF) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), në njësitë administrative në të cilat do të kryhet pilotimi i kësaj skeme.

Objektivat që synohen të arrihen kanë të bëjnë me: (i) vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar sipas standardeve ndërkombëtare; (ii) vlerësimin e fëmijëve dhe të të rriturve në bazë të kriterëve të veçanta të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për fëmijë dhe të rritur; (iii) të realizojë një proces vlerësimi që jo vetëm përcakton një gjendje mjekësore të individit por edhe të impaktit në funksionet e trupit, pjesëmarrjen dhe aktivitetet e jetës së përditshme si dhe lehtësuesit dhe barrierat mjedisore; (iv) shmangien e diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë brenda grupeve të aftësisë së kufizuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, Kapitulli 3 “Shërbimet Publike”, seksioni 3.3 “Shëndetësia dhe Kujdesi Social” dhe hartohet jashtë programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit, për vlerësimin e përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmësit personal si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i propozuar synon vazhdimin e zbatimit të sistemit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, sistem i cili është konceptuar që në nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të reformimit të asistencës sociale ratifikuar me Ligjin Nr. 84/2012, datë 18.09.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale” dhe vijon të mbështetet në kuadër të ligjit nr. 53/2018, datë 23.7.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Me ratifikimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në vitin 2013 dhe me miratimin e Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe ndryshimet ligjore në Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar me Ligjin 44/2016, nisi zbatimi i këtij procesi në njësitë administrative Nr. 6 dhe Nr. 7 të Bashkisë Tiranë.

Kjo reformë do të shtrihet në mënyrë progresive në të gjithë vendin, duke filluar shtrirjen në qarkun e Tiranës brenda vitit 2019, në përputhje edhe me dokumentin politik “Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij”, miratuar me Vendim nr. 380, datë 5.6.2019 të Këshillit të Ministrave.

Zbatimi i këtij modeli vlerësimi është bërë i nevojshëm për disa arsye si: (a) reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësim bio-psiko-social, për të reflektuar konceptin e ri të aftësisë së kufizuar si një ndërveprim të dëmtimeve të shkaktuara nga një sëmundje me faktorët psikologjikë e socialë; (b) rritja e efikasitetit të vlerësimit, duke krijuar mekanizma administrative që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe ulin koston e vlerësimit dhe (c) përmirësimi i shërbimit për qytetarët.

Përmirësimi i sistemit aktual të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara si pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale është konsideruar si një domosdoshmëri prej disa vitesh, për shkak se modeli aktual i vlerësimit të aftësisë së kufizuar është

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit, për vlerësimin e përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre”.

tërësisht i bazuar mbi kritere mjekësore dhe nuk merr në konsideratë nevojat e individit për tu përfshirë në jetën sociale, ndërkohë që sistemi bio-psiko-social ndërvepron me skema të tjera integrale si punësimi, shërbimet sociale rehabilituese dhe arsimimi.

Ky sistem vlerësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Kombëtar Elektronik për Personat me Aftësi të Kufizuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronja c të nenit 30, të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk ka përputhshmëri me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese E PËRmbajtjes Së PROJEKTAKTIT

Në Kreun I të projektvendimit “Objekti dhe subjektet përfituese” është parashikuar që në këtë proces të ri vlerësimi të përfshihen të gjithë personat që kërkojnë të komisionohen për herë të parë si edhe përfituesit ekzistues. Zbatimi i skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social të vlerësimit, do të realizohet në qarkun e Tiranës nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar, pas një periudhe pilotimi në njësitë administrative nr. 6 dhe nr. 7 të Bashkisë Tiranë.

Në Kreun II janë parashikuar kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësim/rivlerësim për përfitimin e aftësisë së kufizuar. Duhet theksuar se të gjitha ekzaminimet mjekësore do të kryhen pa kërkuar shtrimin në spital. Formularët do të plotësohen nga mjekët e familjes dhe mjekët specialist/Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor të cilat do të japin jo vetëm diagnozën e kërkuar, por do të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit, për vlerësimin e përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre”.

vlerësojnë edhe shkallën e dëmtimit të strukturave dhe funksioneve trupore si edhe kufizimin e aftësisë për të kryer aktivitetet bazë të jetës së përditëshme.

Në kreun III “Vlerësimi bio-psiko-social” parashikohet procedura e procesit të aplikimit, vlerësimit dhe përfitimit të aftësisë së kufizuar sipas standardeve ndërkombëtare. Ky proces nis me plotësimin e formularëve tek mjeku i familjes, po ashtu i njëjti formular plotësohet edhe nga mjeku specialist/mjeku i QKSHM, të cilat dorëzohen në Drejtorinë Rajonale të SHSSH pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Dokumentacioni shqyrtohet nga grupi multidisiplinar me mjek e punonjës social dhe më pas kryhet intervista me aplikantin. Në përfundim të procesit të vlerësimit individit pajiset me dokumentin e aftësisë së kufizuar.

Kreu IV parashikon përfitimet në pagesa e shërbime për shkak të aftësisë së kufizuar. Baza e pagesës është 150% e shumës së pensionit social dhe këto pagesa përshkallëzohen sipas shkallës së aftësisë së kufizuar (e lehtë, mesatare, e thellë dhe e rëndë) e ndarë kjo për fëmijët dhe për të rriturit.

Përveç pagesës bazë janë parashikuar dhe përfitime të tjera siç janë përfitimet e ndihmësit personal, paketës higjieno-sanitare, përfitimet shtesë gjatë kohës së arsimimit dhe për tituj e grada shkencore. Pagesa shtesë për arsimin kufizohet vetëm në një cikël studimi me qëllim që të ketë një harmonizim me legjislacionin në fushën e arsimit dhe lehtësirat që ky legjislacion parashikon për nxënësit/studentët me aftësi të kufizuar (bursa, përjashtime e reduktime nga taksa e tarifa shkolle, etj). E drejta e ndihmësit personal dhe shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmësit personal përcaktohet nga grupi multidisiplinar i vlerësimit të aftësisë së kufizuar në mënyrë të përshkallëzuar sipas llojit të shërbimit (gjithëpërfshirës apo i herëpashershëm).

Kreu V parashikon procedurën e ankimimit, sipas së cilës aplikuesi ka të drejtën e ankimimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, e cila bëhet me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të refuzimit, për rastet e ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit. Procedura e ankimimit, garanton të drejtën e ezaurimit të të gjitha shkallëve të ankimimit duke parashikuar edhe të drejtën për ankimim pranë Gjykatës Administrative. Po ashtu, në këtë kre parashikohen edhe afatet e lindjes së të drejtës së marrjes së përfitimit pas shqyrtimit të ankesës.

Kreu VI parashikon dispozitat kalimtare, sipas të cilave parashikohen rastet që nuk i nënshtrohen kësaj procedure vlerësimi, përkatësisht të verbërit dhe paraplegjikët e

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës, kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit, për vlerësimin e përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmësit personal si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre”.

tetraplegjikët të cilët gëzojnë status dhe trajtim të veçantë në bazë të status ligjeve në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore dhe sociale dhe njësitë e vetqeverisjes vendore në të cilat zbatohet kjo skemë vlerësimi, për zbatimin e këtij vendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky projektakt dërgohet për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara dhe Këshillin Konsultativ për Qeverisjen Qendrore dhe Vetqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiarë të projektaktit është fondi i pagesave të aftësisë së kufizuar. Burimi i financimit është buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përkatësisht në zërin 606 "Transferat për buxhetet familjare dhe individët" në Programin buxhetor "Përkujdesi Social".

PROPOZUESI



Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masës, kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit, për vlerësimin e përfitimtë dhe aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre".